



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Data _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Blerje eskavatori me goma”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Makineri eskavator - 43262000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 8.166.667(tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” është sepse fondi limit është nën kufirin e ulët monetar, bazuar në ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nenin 49 si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nenin 11, pika 2, gërma b dhe neni 55, 74, 77.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2 pika 2/c dhe nenit 78 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vau Dejes ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; Ne masen 2% te fondit limit, 163.333(njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre)lek*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Kërkesa për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 83 pika 1 si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30 pika 1.

Këto kritere janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kritere janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së perlologaritur të kontrates.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nese operatorët ekonomik arrijne vleren e xhiros minimale ne te pakten 1 (nje) vit te periudhes se kerkuar te viteve financiare.

Argumentimi: Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit: **“Blerje eskavatori me goma”** neni 77 pika 3 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe nenin 43 pika 2 germa c të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar..”*, Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2024, 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance e kerkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43 pika 1, 2/c, 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës konkretisht, Ligjit nr. 10091 date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi dy vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar: *“Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji”*.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve vjetore është bërë bazuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar e cila parashikon se Autoriteti Kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 (sipas kesteve të maturuara), në zbatim të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në

këtë ligj. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.1 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Per kontratat e realizuar si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: Kontraten e bashkimit te operatoreve te deklaruar ne fazen e tenderimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik i ndryshuar, dhe në nenin 55, pika 4/ b e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: “Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie”. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar parashikon se: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik i ndryshuar, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në

shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”.

AK argumenton se furnizimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë garancie për mjetin e ofruar, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi, si dhe periudha e garancisë teknike jo më pak se 1 (një) vit nga marrja në dorëzim e mallit, objekt prokurimi.

Argumentim: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe të nenit 40 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga Operatori Ekonomik dhe dhënia e sigurisë Autoritetit Kontraktor që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar Autoritetit Kontraktor produkt (mjet) funksional dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallit objekt prokurimi si dhe për t’u garantuar se për një periudhë të arsyeshme prej 1 viti malli objekt prokurimi do të përmbushë specifikimet teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat që mund të lindin, jo për faj të Autoritetit Kontraktor.

b) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë me anë të një deklarate se nëse shpallet fitues do të mbulojnë shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të Bashkisë Vau Dejës.

Argumentim: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe të nenit 40 pika 8 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar i cili parashikon: “8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga Operatori Ekonomik dhe kalimin e pronësisë pa patur kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor pasi ky i fundit nuk ka parashikuar kosto të tjera.

c) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në të cilën merr përsipër që mjeti i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë nenit 40 pika 8 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë që mjeti që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.5 Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26 pika 1 e VKM-së, nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të Hartuara janë bazuar në nevojat e Autoritetit Kontraktor bazuar në nenin 40 pika 2 e VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar për të patur një Automjet cilësor e të përshtatshëm për funksionalitetin e veprimtarive që zhvillohen.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË KËTIJ OBJEKTIT PROKURIMI JANË PËRCAKTUAR NGA PERSONI I NGARKUAR PER LLOGARITJE E FONDIT LIMIT DHE SPECIFIKIME, SIPAS MATERIALIT BASHKËLIDHUR NË SPE.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të Autoritetit Kontraktor për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **“Blerje eskavatori me goma”** me fond limit prej: 8.166.667(tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) leke pa tvsh **leke pa TVSH, lloji i procedures: E hapur e thjeshtuar.**

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

Sasia e mallit që kërkohet:

PREVENTIV

Nr	Nr. An.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Treg	Blerje ekskavatori me goma	copë	1
		SHUMA		
		TVSH 20%		
		TOTALI		

Afatet e lëvrit: Fillon nga data e **lidhjes së kontratës dhe** mbaron deri më **1 (nje) muaj**.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t'u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT